



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, 26 maj 2009, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Morën pjesë: Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Gjylnaze Sylja, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi, Nurishahe Hulaj dhe Qamile Morina.

Munguan: Sadik Idriz dhe Sllobodan Petroviq.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore: nga NDI-ja: Shefki Kastrati: nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri: nga KDI-ja: Rrezarta Ahmeti,

Mbledhjen e kryesoi Rita Hajzeraj - zëvendëskryetare e Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i propozimit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008 ;**
- 4. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 – 2012;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i propozimplanit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008

Kryesuesja Rita Hajzeraj -Tha se në propozimplanin e veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, nga fushëveprimi i Komisionit parashihen përmbushja e tri pikave: P - 73, P - 74 dhe P - 109. Për të diskutuar për përmbushjen e këtyre pikave, mund t'i ftojme përfaqësuesit e ministrisë përkatëse. Për këtë pikë e hap diskutimin dhe ftoi deputeten Mimoza Ahmetaj ta njoftojë Komisionin lidhur me pjesëmarrjen në tryezën e organizuar për këtë propozimplan.

Mimoza Ahmetaj - Pati vërejtje për punën e Komisionit, që nuk ka ndërmarrë aktivitetet të duhur lidhur me këtë plan, ashtu si kanë vepruar komisionet e tjera. Propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, por të kërkohet edhe raport me shkrim rreth përmbushjes e këtyre pikave të planit.

Në këtë konferencë kam theksuar se nuk mund t'i kemi Ligjin për grevat dhe Ligjin për sindikatat, derisa nuk e kemi Ligjin e punës, që nuk mund të miratohet për shkak të implikimeve buxhetore.

Armend Zemaj - Theksoi se ministrinë përkatëse kanë zyra për integritet evropian, prej të cilave mund të kërkojmë raport për realizimin e këtyre pikave.

Gjylnaze Syla – Pajtohet me propozimin që MPMS të dërgojë raport me shkrim dhe t'i raportojë Komisionit. Gjithashtu propozoi që Komisioni t'i drejtohet ministrit dhe ministri t'i autorizojë personat përgjegjës për përgatitjen e raportit.

Rita Hajzeraj - sipas diskutimeve nxori këtë :

Përfundim

Të kërkoj nga MPMS të paraqes raport me shkrim rreth zbatimit të pikave të parapara në propozim - planin e Kuvendit të Kosovës, për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Të ftohen përfaqësuesit e MPMS që të marrin pjesë në mbledhjen e radhës të Komisionit dhe të raportojnë lidhur me këto pika.

4. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 – 2012

Rita Hajzeraj - Theksoi se Komisioni ka për detyrë ta shqyrtojë Kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore në aspektin e shpenzimeve të parapara nga sektori i shëndetësisë, i punës e mirëqenies sociale. Nga ajo që kam vërejtur MSH ka paraparë edhe shumë për shpenzimet shtesë, ndërsa MPMS nuk e ka paraparë shumë për shpenzimet shtesë. Ne mund ta formojmë një grup pune ose mund të punojmë secili individualisht lidhur me vërejtjet.

Qamile Morina - Tha se Korniza afatmesme e shpenzimeve buxhetore është në pajtim me programin e Qeverisë dhe ndoshta do të ishte mirë që, si pozita ashtu edhe opozita, t'i ketë komentet e veta. Shtegu fiskal për periudhën afatmesme paraqet vështirësi të mëdha për të ardhmen, sepse bilanci bankar është shumë i shterur, ndërsa rezervat prej 200

milione eurove duhet të jenë të qëndrueshme. Çështja e zvogëlimit të papunësisë nga 40% në 20 % për periudhën e ardhshme 3 -vjeçare do të arrihet vetëm nëse e kemi rritjen ekonomike për 6.5% , porse rritja ekonomike të ne po zvogëlohet.

Teuta Hadri - Shtoi se Komisioni duhet t'i japë vërejtjet e veta vetëm në çështjet e shëndetësisë dhe të punës e të mirëqenies sociale. Pajtohet me propozimin që të formohet një grup pune.

Nurishahe Hulaj - Tha se në këtë kornizë janë paraparë projektet e miratuara. Këtu vërehet një rritje e buxhetit të shëndetësisë prej 7 milionë euro. Buxheti për shpenzime kapitale është në rritje.

Flora Brovina - Theksoi se do të ishte mirë ta studiojmë më mirë çështjen e "letrës së bardh", sepse ajo ndërlidhet me Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Në grupin e punës të angazhohet kryesia e Komisionit - kryetari dhe nënkryetarja, porse edhe anëtarët e tjerë të Komisionit mund të bëjnë vërejtje.

Rita Hajzeraj - Tha se nuk është e mendimit që vetëm kryesia e Komisionit të merret me shqyrtimin e kornizës, sepse për shqyrtimin dhe plotësimin e kësaj kornize nevojiten propozimet e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

Armend Zemaj - Shtoi se në Kornizën afatmesme të shpenzimeve nuk mund të ndërhyhet shumë, sepse këto janë prioritetet e ministrive përkatëse. Në bashkëpunim me ministrinë mund të miratojmë buxhetin për vitin e ardhshëm, të ndihmojmë ministrinë përkatëse në realizimin e kornizave të parapara edhe në realizimin e projekteve kapitale.

Nurishahe Hulaj - Propozoi që në këtë kornizë të shpenzimeve të futet një linjë e veçantë buxhetore për zbatimin e ligjeve në shëndetësi.

Rita Hajzeraj - pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit nxori këtë :

Përfundim

Të ftohen përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, që të diskutohet për Kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore për periudhën 2010- 2012.

5. Të ndryshme

Rita Hajzeraj – Theksoi se në këtë pikë kemi një ankesë të mjekëve specialistë dhe specialistëve të biokimisë klinike, që kërkojnë shfuqizimin e vendimit të Qeverisë, për njohjen e titullit të laborantit të lartë mjekësor dhe të biologëve të biologjisë aplikative. Ata kërkojnë takim me Komisionin dhe kundërshtojnë vendimin e Qeverisë me arsyetimin se është në kundërshtim me Ligjin për shëndetësi. Hap diskutimin.

Nurishahe Hulaj - Tha se studentet e biologjisë aplikative kërkojnë që t'u jepet e drejta të punojnë në laboratorë si bashkëpunëtorë shëndetësorë, por jo të kenë të drejtë të hapin laboratorë. Këta mund të jenë asistentë të biokimistëve, por jo të hapin laborator.

Teuta Hadri - Shtoi se nuk pajtohet që biologët e diplomuar të kenë të drejtë vetë të hapin laboratorë, mirëpo për punësim, si ndihmës në laboratorë, janë kriteret e punësimit dhe askush nuk mund t`ua ndalojë të punësohen në laboratorë.

Flora Brovina - Tha se ne kemi pranuar sistemin arsimor të Bolonjës dhe Ministria e Arsimit e ka pranuar këtë sistem, ndërsa Ministria e Shëndetësisë nuk e pranon, sepse nuk ka ku t`i sistemojë këta studentë.

Gjynaze Syla – Propozoi që parashtruesit e ankesës të ftohen për t`u dëgjuar në një nga mbledhjet e Komisionit. Sa i përket vendimit të Qeverisë, ne duhet të shikojmë nëse ky vendim është ligjor, por duhet të shikojmë nëse ky vendim është në kundërshtim me Ligjin e shëndetësisë.

Qamile Morina - Tha se vendimi i Qeverisë mbështetet në nenet 92 dhe 93 të Kushtetutës, si dhe në nenin 86 (h) të Ligjit të Shëndetësisë. Duhet të shikojmë nëse kjo mbështetje është e drejtë ose jo.

Bujar Bukoshi - Shtoi se nuk pajtohet që të diplomuarit – biologë aplikativë, me një cikël plotësues, të jenë të barabartë me mjekët biokimistë.

Rita Hajzeraj - Në bazë të diskutimeve propozoi që në mbledhjen pas dy javësh të ftohen parashtruesit e ankesës, përfaqësuesit e rektoratit dhe të Komisionit të Qeverisë që ka marrë këtë vendim që të diskutohet ankesa e biokimistëve.

Qamile Morina - Tha se ka sjellë propozimin e shkresës që do t`i drejtohet ministrit të Shëndetësisë lidhur me komentet për mbikëqyrjen e Ligjit për veprimtarinë shëndetësore private.

Propozoi të fillojë edhe mbikëqyrja edhe e ndonjë ligji, sidomos të fushës së shëndetësisë. Por propozoi të bëhet një vizitë në QKUK, lidhur me furnizimin me barna.

Mimoza Ahmetaj - Shtoi se javën e kaluar kemi caktuar për mbikëqyrje Ligjin për skemën e ndihmës sociale. Vizita në QKUK ka qenë propozim i kryetarit të Komisionit edhe në mbledhjen e kaluar.

Teuta Hadri - Tha se patjetër duhet ta vizitojmë QKUK- në, sepse gjendja e furnizimit me barna nuk është aspak e mirë.

Qamile Morina - Theksoi se kur mbikëqyrej zbatimi i Ligjit për shëndetësi, Kuvendi i nxori disa rekomandime, që nuk po zbatohen. Ne duhet ta realizojmë vizitën në QKUK dhe të njoftohemi për zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe për gjendjen e furnizimit me barna.

Nurishahe Hulaj - Propozoi që si pikë e rendit të ditës të jetë shqyrtimi i realizimit të Planit të punës të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 00.

E hartoi
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

zv. Kryetare e parë e Komisionit

Rita Hajzeraj